

## VËSHTRIM MBI TREGJET

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2016
- Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 shtator 2016
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 shtator 2016

## ZHVILLIME TË TJERA

- *Workshop-i* me përfaqësues të tregut të kapitaleve në vend mbyll fazën e parë të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”
- AMF vijon zbatimin e projektit të reformës në tregun e sigurimeve
- Zhvillohet Konferenca e 23-të Vjetore dhe Mbledhjet e Komiteteve të IAIS-it
- AMF merr pjesë në Kolegjin Mbikëqyrës për Grupin e Sigurimit UNIQA
- Zhvillohet Forumi Global mbi Pensionet Private dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e IOPS-it
- Seminar “Mbi çështjet e Librit të Tregtueshëm (*Trading Book*) dhe Infrastrukturës së Tregut me fokus të veçantë në çështjet rregullatore, ligjore dhe ato të përputhshmërisë”
- Mbi pjesëmarrjen në kolegjin e organizuar nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar për Grupin e Sigurimit VIG
- Seminar për mbikëqyrjen efikase të tregjeve

## EDUKIMI I KONSUMATORIT

- “Eksplorimi i Horizonteve të Reja” - Fjala e Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*)

## LAJME NDËRKOMBËTARE

- Çeki
- Gjeorgji
- Hungari
- Kroaci
- Moldavi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-tetor 2016 kapën vlerën mbi 12 miliardë lekë, ose 8.10% më shumë se gjatë periudhës janar-tetor 2015. Gjatë periudhës janar-tetor 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 903,881 me një ulje prej 0.57% krahasuar me periudhën janar-tetor 2015.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 32.59% në krahasim me periudhën janar-tetor 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 2.22 miliardë lekë, apo 63.42% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 8.75% gjatë periudhës janar-tetor 2016, krahasuar kjo me periudhën janar-tetor 2015.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 7.48 miliardë lekë gjatë periudhës janar-tetor 2016, duke shënuar një rritje prej 10.16% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.49% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 11.97% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 12.76 % të tregut të Jo-Jetës.

### Sigurimi i Jetës


Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 3.45% krahasuar me periudhën janar-tetor të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 7.48 miliardë lekë gjatë periudhës janar-tetor 2016, duke shënuar një rritje prej 10.16% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 57.93% të sigurimit të Jetës.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



## Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 shtator 2016

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30 shtator 2016 tregon një total asetesh neto prej 1,195.10 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 266.36 milionë lekë (28.68%) krahasuar me fundin e vitit 2015.

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2016, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30 shtator 2016 tregon një total asetesh neto prej 1,195.10 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 266.36 milionë lekë (28.68%) krahasuar me fundin e vitit 2015.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.09.2016 ishte 15,957 anëtarë duke shënuar rritje prej 27.06% krahasuar me fundin e vitit 2015.


### Tregues të fondeve të pensioneve

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
	31.12.'15	30.09.'16	
<b>Letra me Vlerë të Qeverisë</b>			
Asetet neto të FP	928.74	1,195.10	28.68


## Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve

Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL	5,679	595.88
RAIFFEISEN	2,643	392.29
SiCRED PENSION	7,635	206.93
<b>TOTAL</b>	<b>15,957</b>	<b>1,195.10</b>

## Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 30.09.2016 (në %)



## Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 30.09.2016 (në %)



## Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 shtator 2016

Gjatë periudhës janar-shtator 2016, në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj”, Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro” dhe Fondi i Investimeve “Credins Premium”.

Fondi i Investimeve “Credins Premium” filloi aktivitetin e tij në datë 1.08.2016, nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest”.

Gjatë periudhës janar-shtator 2016, në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj”, Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro” dhe Fondi i Investimeve “Credins Premium”.

“Credins Invest” është shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”, e cila u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më datë 30.05.2016, për të kryer veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, krahas administrimit të fondeve të pensionit.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve në 30.09.2016, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti mbi 69.76 miliardë lekë me një rritje prej 4.13%, krahasuar me 31.12.2015.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 65.14% të aseteve të fondeve, me një ulje prej 3.63% krahasuar me 31.12.2015.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.09.2016 është 30,961.

## ZHVILLIME TË TJERA

### **Workshop-i me përfaqësues të tregut të kapitaleve në vend mbyll fazën e parë të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”**

Workshop-i përkoi me mbylljen e fazës së parë të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”.

Më 4 nëntor, AMF organizoi një *workshop* të zgjeruar me përfaqësues të tregut të kapitaleve në vend. *Workshop-i* përkoi me mbylljen e fazës së parë të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”. Pjesëmarrës në këtë *workshop* ishin përfaqësues të shoqërive që operojnë në tregun e fondeve të investimeve, fondeve të pensionit, bankave depozitare të aseteve të këtyre fondeve, Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë si edhe Bankës Botërore si mbështetëse e këtij projekti.

Gjatë fjalës së hapjes, Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së Znj. Enkeleda Shehi, prezantoi ecurinë e tregjeve të kapitaleve, dinamikën e shpejtë të rritjes së tregut të fondeve të investimeve, si edhe zgjerimin e tregut të fondeve të pensioneve. Znj. Shehi theksoi ndryshimet e rëndësishme strukturore, që ka kaluar tregu i fondeve të investimeve duke përbërë kështu një hap pozitiv përpara, drejt zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe mbështetjes së tregut financiar në përgjithësi. Duke vënë theksin tek kuadri ligjor që rregullon tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së, Znj. Shehi theksoi rëndësinë e ndryshimeve të miratuara në ligjin “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” si edhe saktësimin e kompetencave të Autoritetit për të vendosur rregulla për kuadrin e administrimit të riskut, në funksion të mbrojtjes së interesit të investitorëve.

Znj. Shehi, duke parashtruar edhe sfidat e së ardhmes në rregullimin e këtyre tregjeve, vlerësoi projektin dhe ekspertizën e huaj si një mundësi për t'i paraparirë zhvillimeve në Shqipëri.

Ekspertët e kompanisë “Cadogan Financial” që asistojnë AMF-në në realizimin e këtij projekti, Znj. Sally Buxton dhe Z. Mark St. Giles bënë një përshkrim të gjetjeve dhe prezantuan rezultatet e fazës së parë të projektit që përfundoi në 14 nëntor 2016. Ata theksuan hartimin e një strategjie afatmesme, një harte veprimi për rregullimin në vazhdimësi të këtyre tregjeve dhe përballjen me sfidat e së ardhmes. Krahas vlerësimeve të tjera, ekspertët nënvizuan se mungesa e tregut dytësor e bën të pamundur vlerësimin sipas tregut “*market to market*” dhe ofruan si alternativë metodën “*market to model*”.

Më parë, në kuadër të projektit u organizua një *workshop* edhe me specialistë dhe ekspertë të stafit të Autoritetit. Në prezantimin e rezultateve të fazës së parë merrnin pjesë drejtues të Autoritetit dhe drejtues të misionit të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri.

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, ka filluar në muajin korrik të vitit 2016. Ky projekt mbështetet nga Banka Botërore dhe financohet nga një *grant (Trust Fund Grant)* me kontributin e Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

## **AMF vijon zbatimin e projektit të reformës në tregun e sigurimeve**

Në kuadër të zbatimit të projektit *FIRST Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative)* “Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve”, në periudhën 9-11 nëntor 2016, pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u zhvilluan takime dhe diskutime pune me përfaqësuesit e Bankës Botërore. Ky projekt, i cili realizohet me mbështetjen e Bankës Botërore, synon të ndihmojë AMF-në në zbatimin e reformave ligjore dhe rregullatore që kanë të bëjnë me forcimin e mbikëqyrjes, si dhe nxitjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve.

Drejtuesit dhe specialistët e AMF-së, gjatë takimeve me përfaqësuesit e Bankës Botërore, biseduan rreth zhvillimeve të fundit në tregun e sigurimeve, si dhe trajtuan disa nga komponentët e projektit. Gjatë këtyre takimeve u diskutuan detaje teknike që lidhen me hartimin e manualeve të mbikëqyrjes së dëmeve nga MTPL dhe prona (për klasat e Jo-Jetës), manuale inspektimi të sigurimit të Jetës dhe risigurimit.

Projekti “Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve” ka filluar në korrik të vitit 2014 dhe do të përfundojë zbatimin e tij më 31 mars 2017, me finalizimin e të gjithë komponentëve të projektit.

Ekspertët e kompanisë “Cadogan Financial” që asistojnë AMF-në në realizimin e këtij projekti, Znj. Sally Buxton dhe Z. Mark St. Giles bënë një përshkrim të gjetjeve dhe prezantuan rezultatet e fazës së parë të projektit që përfundoi në 14 nëntor 2016.



## Zhvillohet Konferenca e 23-të Vjetore dhe Mbledhjet e Komiteteve të IAIS

Në datat 7-9 nëntor 2016 u zhvilluan mbledhjet e Komiteteve të Stabilitetit Financiar, Implementimit dhe Buxhetit, të cilat i paraprinë Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore të IAIS. Gjatë mbledhjeve të Komiteteve të IAIS-it dhe Konferencës u diskutua mbi zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe sfidat me të cilat përballlet kjo industri. Në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të IAIS-it, anëtarët miratuan Raportin Vjetor, pranuan dy anëtarë të rinj dhe zgjodhën e rizgjodhën disa prej anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv.

Në datat 10 dhe 11 nëntor 2016 u zhvillua Konferenca e 23-të Vjetore e IAIS-it. Mbledhjet dhe Konferenca Vjetore u organizuan në Asuncion, Paraguaj, ku u mbledhën së bashku më shumë se 300 pjesëmarrës nga vendet anëtare të IAIS-it, si edhe palët e interesuara. Në sesionet e Konferencës Vjetore kishte panele me tematika të ndryshme si ato lidhur me mbikëqyrjen me bazë rreziku, stabilitetin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve, mbajtësit e policave të sigurimit dhe risitë teknologjike në tregun e sigurimeve. Një ndër tematikat e trajtuara lidhej edhe me zhvillimin e tregut të sigurimeve si një nxitës për të pasur rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në njërin nga panelet, diskutimi u fokusua në iniciativën e ndërmarrë nga IAIS për të rishikuar strukturën ekzistuese *ComFrame* duke integruar tekste në formatin e Parimeve Bazë të Sigurimeve (ICP) gjatë muajve të ardhshëm.

Duke vlerësuar bashkëpunimin e të gjithë aktorëve përgjatë këtyre veprimtarive, Sekretari i Përgjithshëm i IAIS-it, Z. Yoshihiro Kawai, i vlerësoi mbledhjet, takimet dhe Konferencën si mjaft produktive "... për të çuar përpara iniciativat e ndërmarra nga IAIS nëpërmjet diskutimeve dhe angazhimeve. Ndërkohë që 2017 do të sjellë për IAIS një tjetër vit të rëndësishëm, ne mirëpresim bashkëpunimin e vazhdueshëm për ecjen përpara në arritjen e qëllimeve të rëndësishme".

IAIS është një organizatë botërore me objektiv vendosjen e standardeve dhe promovimin e praktikave më të mira të mbikëqyrjes në industrinë e sigurimeve, duke ndihmuar në zhvillimin e këtij tregu krahas edhe mbrojtjes së të siguruarve dhe për të kontribuar në stabilitetin financiar global. Anëtarësia e saj përfshin rregullatorët dhe mbikëqyrësit e tregjeve të sigurimeve nga më shumë se 200 juridiksione në rreth 140 vende. AMF është anëtare e këtij organizmi që prej vitit 2001 (si vazhduese e veprimtarisë së ish Autoritetit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve).

## AMF merr pjesë në Kolegjin Mbikëqyrës për Grupin e Sigurimit UNIQA

Përfaqësues nga Departamenti i Mbikëqyrjes Financiare të AMF-së morën pjesë në mbledhjen e Kolegjit të Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit UNIQA. Mbledhja u organizua më datë 7 nëntor 2016 në Vjenë, Austri

Duke vlerësuar bashkëpunimin e të gjithë aktorëve përgjatë këtyre veprimtarive, Sekretari i Përgjithshëm i IAIS-it, Z. Yoshihiro Kawai, i vlerësoi mbledhjet, takimet dhe Konferencën si mjaft produktive "... për të çuar përpara iniciativat e ndërmarra nga IAIS nëpërmjet diskutimeve dhe angazhimeve.

nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar.

Mbledhja u nda në tre faza:

- Faza e parë konsistoi në prezantimin nga përfaqësues të menaxhimit të UNIQA Group, të të dhënave financiare për Grupin UNIQA për vitin 2015, dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, të masave strategjike në nivel Grupi dhe nivel individual bazuar në rezultatet e vetëvlerësimit (ORSA) të Grupit, si dhe të strategjisë së investimeve në sisteme të TI-së;
- Gjatë fazës së dytë u prezantuan çështjet kryesore të identifikuara dhe masat e marra në sajë të vlerësimit të rrezikut gjatë vitit të shkuar, përfshi këtu edhe rezultate të analizës së vetëvlerësimit (ORSA), rezultate të nxjerra nga analizat e provës së rezistencës, të kryera mbi UNIQA Group nga EIOPA, si dhe një përmbledhje të aktiviteteve kryesore “on-site” dhe “off-site” gjatë vitit 2015;
- Faza e tretë kishte prezantime të përfaqësuesve të autoriteteve të çdo vendi mbi çështjet kryesore dhe zhvillimet e tregut gjatë vitit 2015, si dhe mbi specifikat dhe risqet kryesore të Grupit UNIQA në vendet e tyre.

Të gjitha çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar, si një analizë përmbledhëse nga Kolegji për t'u ndarë me Grupin UNIQA.

## **Zhvillohet Forumi Global mbi Pensionet Private dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e IOPS-it**

Në datat 8-9 nëntor 2016 u zhvillua në Hong Kong, Kinë, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS). Në këtë Mbledhje Vjetore u diskutua mbi konkluzionet e nxjerra nga grupet e punës në lidhje me:

- Praktikën më të mira mbi rolin e rregullatorit për mbrojtjen e konsumatorit në sistemin e pensioneve private;
- Mbikëqyrjen e menaxhimit të investimeve, duke përfshirë investimet jo tradicionale, investimet në infrastrukturë dhe investimet afatgjata;
- Dimensionet makro dhe mikro të mbikëqyrjes së fondeve të mëdha të pensioneve.

Në Mbledhjen Vjetore u diskutua edhe mbi buxhetin, shoqërinë audituese, si dhe mbi projektet e ardhshme.

Në datat 9-10 nëntor 2016 në Hong Kong u zhvillua Forumi Global mbi pensionet private me temë: “Si të funksionojë më mirë tregu i pensioneve private” (*Making Private Pension Work Better*). Forumi u organizua nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (*International*

○ ○ ○  
Të gjitha çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar, si një analizë përmbledhëse nga Kolegji për t'u ndarë me Grupin UNIQA.

○ ○ ○



○○○  
Diskutimet në  
Forum Global u  
fokusuan në një numër  
çështjesh rregullatore  
dhe mbikëqyrëse  
mbështetur në  
shembuj nga procesi i  
reformave të sistemit të  
pensioneve në vende  
të ndryshme të botës.  
○○○

*Organisation of Pension Supervisors, IOPS*) në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (*Organisation for Economic Co-operation and Development, OECD*). Pjesëmarrës në Forum ishin zyrtarë nga autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, ekspertë të nivelit të lartë nga industria e fondeve private të pensionit dhe institutet kërkimore nga vendet anëtare të organizatave OECD dhe IOPS. Në Mbledhjen Vjetore dhe në Forumin Global mori pjesë edhe AMF, si vend anëtar i IOPS-it, duke u përfaqësuar nga Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorja e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit.

Diskutimet në Forumin Global u fokusuan në një numër çështjesh rregullatore dhe mbikëqyrëse mbështetur në shembuj nga procesi i reformave të sistemit të pensioneve në vende të ndryshme të botës. Drejtues të autoriteteve të pensioneve dhe ekspertë nga Afrika e Jugut, Hong Kongu, Indonezia, India, Kanadaja, Kili, Kina, Meksika, Singapori, Sllovakia prezantuan eksperiencat e tyre duke identifikuar praktikat më të mira nga vendet anëtare të OECD-së dhe IOPS-it.

Tematikat kryesore të trajtuara në sesione lidheshin me:

- Prezantimin e Parimeve Kryesore të rishikuara të OECD-së për rregullimin e pensioneve private (*Revised OECD Core Principles of Private Pension Regulation*);
- Strategjitë për reduktimin e tarifave në sistemin e pensioneve private – mësimet e nxjerra nga rregullatorët e pensioneve private;
- Ndërveprimin midis pensioneve private dhe publike në disa vende të përzgjedhura;
- Mbrojtjen e konsumatorit nga konfliktet e interesit që mund të kenë këshilluesit për sistemin e pensioneve private;
- Lidhjen midis akumulimit dhe fazës së marrjes së pagesave të pensionit.

### **Seminar “Mbi çështjet e Librit të Tregtueshëm (*Trading Book*) dhe Infrastrukturës së Tregut me fokus të veçantë në çështjet rregullatore, ligjore dhe ato të përputhshmërisë”**

Gjatë periudhës 16-18 nëntor 2016, në Madrid, Spanjë u zhvillua seminari me temë “Mbi çështjet e Librit të Tregtueshëm (*Trading Book*) dhe Infrastrukturës së Tregut me fokus të veçantë në çështjet rregullatore, ligjore dhe ato të përputhshmërisë”. Seminari u organizua nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në bashkëpunim me Institutin e Stabilitetit Financiar (FSI).

Ky ishte event i 11-të vjetor, i organizuar nga FSI dhe IOSCO, në të cilin u ofrua informacioni më i fundit përsa i përket çështjeve rregullatore dhe atyre të mbikëqyrjes për punonjësit e bankave qendrore, autoriteteve mbikëqyrëse dhe komisioneve të letrave me vlerë.

Seminari ishte i organizuar në sesione prezantimesh tematike dhe diskutimesh nga pjesëmarrësit.

Ndër çështjet kryesore të trajtuara në seminar ishin:

- Çështjet rregullatore, ligjore dhe ato të përputhshmërisë të librave të tregtueshëm në banka dhe tregje të tjera të lidhura për aktivitetet e tregtueshme;
- Puna e bërë nga Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturës së Tregut (CPMI) dhe IOSCO përsa i përket elasticitetit dhe shëndetit të mirë financiar të Kundrapartive Qëndrore, ndikimet e inovacioneve dixhitale, elasticitetit kibernetik (*cyber*) të institucioneve financiare, si edhe rishikimi i Librit të Tregtueshëm nga BCBS dhe sfidat e zbatimit të kërkesave të reja rregullatore për këtë çështje;
- Menaxhimi i aseteve, harmonizimi i të dhënave, kuadri rregullator ndërkombëtar, si edhe puna e realizuar së fundmi nga IOSCO dhe CPMI mbi monitorimin e zbatimit si dhe çështjet më të fundit të zbatimit global.

### **Mbi pjesëmarrjen në kolegjin e organizuar nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar për Grupin e Sigurimit VIG**

Më 23 nëntor 2016 Autoriteti Austriak i Tregut Financiar zhvilloi mbledhjen e Kolegjit Mbikëqyrës për *Vienna Insurance Group, VIG*. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe një specialiste e kësaj drejtorie.

Mbledhja ishte e organizuar në tre seksione:

- Në seksionin e parë u prezantuan nga përfaqësuesit e menaxhimit të Grupit VIG, të dhënat financiare për Grupin për vitin 2015 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2016. Gjithashtu u prezantuan edhe masat strategjike në nivel Grupi dhe individual bazuar në rezultatet e vetëvlerësimit (ORSA) të Grupit, si dhe të strategjisë së investimeve në sisteme të TI-së;
- Sesioni i dytë konsistoi në prezantimin e çështjeve kryesore të identifikuar dhe masave të marra në sajë të vlerësimit të rrezikut gjatë vitit të shkuar, përfshirë këtu edhe rezultatet e analizës së vetëvlerësimit (ORSA), rezultateve të nxjerra nga analizat e provës së rezistencës, të kryera mbi VIG Group nga EIOPA, si dhe një përmbledhje të aktiviteteve kryesore “*on-site*” dhe “*off-site*” gjatë vitit 2015;
- Gjatë sesionit të tretë u bënë prezantime nga përfaqësuesit e autoriteteve të çdo vendi mbi specifikat dhe risqet kryesore që karakterizojnë Grupin VIG në vendet e tyre.

Raportimet dhe çështjet kryesore të prezantuara u përmbledhën në një

—○○○—  
Më 23 nëntor 2016  
Autoriteti Austriak i  
Tregut Financiar zhvilloi  
mbledhjen e Kolegjit  
Mbikëqyrës për Vienna  
Insurance Group, VIG.  
—○○○—

material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar si një analizë përmbledhëse nga Kolegji Mbikëqyrës për t'u ndarë me Grupin VIG.

## Seminar për mbikëqyrjen efikase të tregjeve

Në datat 23-25 nëntor 2016 në Paris, Francë, Autoriteti i Tregjeve Financiare të Francës (*Autorité des Marchés Financiers, AMF*) organizoi seminarin me temë “Kryerja e një mbikëqyrjeje efikase të tregut: mjetet dhe sfidat”. Nëpërmjet prezantimeve tematike dhe pasqyrimin të rasteve të ndryshme studimore, lektorët nga Autoriteti i Tregjeve Financiare të Francës vunë theksin në kushtet gjeopolitike, në krijimin e një ambienti jo të sigurt për tregjet financiare, sidomos mbas referendumit të Brexit dhe zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues nga vende të ndryshme si Anglia, Çekia, Estonia, Kanada, Kroacia, Malta, Maroku, Polonia, Sllovenia.

Gjatë këtij seminari u trajtuan tema si:

- Rritja e transparencës në raportimin financiar;
- Monitorimi i qeverisjes së korporatave dhe iniciativat;
- Rregullimi dhe sfidat e financimit të projekteve me bazë të gjerë kontribuesish (*crowdfunding*);
- Ruajta e efikasitetit dhe integritetit të tregut;
- Roli i rregullatorit në mbikëqyrjen e infrastrukturës së tregut;
- Rregullimi dhe mbikëqyrja e ndërmjetësve;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i informacionit;
- Ndërhyrja e hershme: identifikimi i rreziqeve dhe tendencave të sektorit.

—○○○—  
Rastet studimore të trajtuara nga lektorët ishin mbi manipulimet në treg. Theksi u vu në mënyrë të veçantë tek informacioni që i jepet publikut, i cili duhet të jetë preciz, i saktë dhe i paraqitur në mënyrë të drejtë.

Rastet studimore të trajtuara nga lektorët ishin mbi manipulimet në treg. Theksi u vu në mënyrë të veçantë tek informacioni që i jepet publikut, i cili duhet të jetë preciz, i saktë dhe i paraqitur në mënyrë të drejtë.

Në të gjitha temat e trajtuara u vu theksi te harmonizimi me kuadrin legjislativ evropian, sidomos direktiva MiFID II (*Markets in Financial Instruments Directive*), e cila u përcaktua si perspektiva e re evropiane për instrumentet financiare. Zbatimi i MiFID II do të jetë një ndryshim i madh, dhe do të ketë ndikim të ndjeshëm në tregjet financiare, për t'i bërë ato më të integruara, më efikase dhe konkurruese duke përmirësuar mbikëqyrjen e transparencën dhe duke rritur mbrojtjen e investitorëve.

## “Eksplorimi i Horizonteve të Reja”

Fjala e Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA) mbajtur në Konferencën e 6-të Vjetore në Frankfurt, 18 tetor 2016. Duke reflektuar vizionin dhe strategjinë e re të EIOPA-s tematika e konferencës u fokusua në “Eksplorimin e horizonteve të reja” nëpërmjet tre paneleve. Tematikat kryesore të fjalës së mbajtur nga Z. Bernardino lidheshin me katër çështje: (i) metoda gjithëpërfshirëse e EIOPA-s për konvergencën në mbikëqyrje (supervisory convergence); (ii) zhvillimi i produkteve personale të pensionit në Europë (Pan-European Personal Pension Product, PEPP) në kuadrin e Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit; (iii) prioritetet e axhendës së EIOPA-s për mbrojtjen e konsumatorit e lidhur me zbatimin e direktivës Insurance Distribution Directive (IDD) në procesin e dixhitalizimit; (iv) hapat e mëtejshëm në kuadrin rregullator dhe sfidat në vazhdim.



Pjesa e parë (marrë me shkurtime)

<https://eiopa.europa.eu/Publications/Speeches%20and%20presentations/2016-10-18%20EIOPA%20Annual%20Conference.pdf>

Ndër vite kemi debatuar mjaft për rreziqet dhe mundësitë që sjell *Solvency II* në industrinë e sigurimeve. Por zbatimi i *Solvency II* sjell gjithashtu edhe sfida për mbikëqyrjen.

Para së gjithash, për të siguruar mbrojtjen e të siguruarit, të gjitha autoritetet mbikëqyrëse në Bashkimin Evropian duhet të kenë mjetet e nevojshme. Atyre u nevojitet ekspertiza përkatëse, kapacitetet dhe mandati për të ekzekutuar këtë mandat në pavarësi të plotë. Në një treg të vetëm, ku biznesi ndërkufitar luan një rol të madh, kjo është thelbësore për të siguruar që sistemi mbikëqyrës nuk ka lidhje të dobëta.

Sfida kryesore për EIOPA në vitet e ardhshme është ndërtimi dhe vënia në vend e një kulture mbikëqyrëse të përbashkët evropiane. Për të siguruar mbikëqyrjen gjithëpërfshirëse, në tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian, komunitetet mbikëqyrëse të sigurimit duhet të zhvillojnë mënyra të përbashkëta të të menduarit, sjelljes dhe punës. Kjo nënkupton një interpretim të përbashkët të ligjeve dhe rregulloreve, një kuptim të përbashkët të objektivave mbikëqyrëse dhe një këndvështrim të përbashkët mbi karakteristikat kryesore të mbikëqyrjes së mirë dhe efektive. Ky është një udhëtim dhe EIOPA është duke punuar së bashku me të gjithë autoritetet mbikëqyrëse kombëtare për të dhënë rezultatet e dëshiruara.

Vetëm një kulturë e përbashkët mbikëqyrëse do të sigurojë një fushë të barabartë veprimi, do të parandalojë veprimet arbitrare rregullatore dhe do të ruajë një nivel të ngjashëm të mbrojtjes për të gjithë të siguruarit dhe përfituesit në Bashkimin Evropian.

Sfida kryesore për EIOPA në vitet e ardhshme është ndërtimi dhe vënia në vend e një kulture mbikëqyrëse të përbashkët evropiane. Për të siguruar mbikëqyrjen gjithëpërfshirëse, në tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian, komunitetet mbikëqyrëse të sigurimit duhet të zhvillojnë mënyra të përbashkëta të të menduarit, sjelljes dhe punës.

EIOPA do të ndërmarrë disa iniciativa në këtë fushë:

- EIOPA po harton një broshurë (*handbook*) të praktikave më të mira mbikëqyrëse në *Solvency II*;
- Po ndërtohet një sistem informacioni bazuar në të dhënat e *Solvency II* i cili do të lejojë zhvillimin e analizave të besueshme të rrezikut dhe treguesve të paralajmërimit të hershëm;
- EIOPA ka vendosur si prioritet të lartë monitorimin në vazhdimësi të modeleve të brendshme, duke punuar kështu në raportet e konsistencës, në trajtimin e borxhit sovran dhe modelimin e luhatshmërisë së rregullimit, sikurse edhe rreziqet e tregut dhe të kreditit;
- EIOPA përdor testet e stresit (*stress tests*) të Bashkimit Evropian për të vlerësuar rreziqet dhe dobësitë dhe për të zhvilluar reagime të përbashkëta dhe të koordinuara për një ambient, i cili, për një kohë të gjatë, ka norma të ulta të interesit;
- EIOPA do të vazhdojë të angazhohet në veprimtarinë bilaterale mbikëqyrëse në vend me autoritetet kombëtare mbikëqyrëse, duke siguruar reagime të pavarura dhe duke sfiduar praktikat mbikëqyrëse;
- EIOPA po mbështet përmirësimet tek mbikëqyrja kombëtare (sikurse kanë qenë rastet e zhvillimit e shqyrtimit të *Balanceve (Balance Sheet)* në rastet e Rumanisë dhe Bullgarisë;
- EIOPA po zbaton një strategji për mbikëqyrjen parandaluese të bazuar në rrezikun (për identifikuar veprimtaritë e ndryshme jo të rregullta, për të hetuar shkaqet dhe zhvilluar reagimet mbikëqyrëse.



Çështja e integritetit të mëtejshëm të mbikëqyrjes në sektorin e sigurimeve në Bashkimin Evropian është veçanërisht një çështje politike. Historia na tregon se zakonisht vendimet e kësaj natyre janë të nxitur nga ngjarjet kritike.

Çështja e integritetit të mëtejshëm të mbikëqyrjes në sektorin e sigurimeve në Bashkimin Evropian është veçanërisht një çështje politike. Historia na tregon se zakonisht vendimet e kësaj natyre janë të nxitur nga ngjarjet kritike. Siç ka theksuar dikur Jean Monnet: “Njerëzit e pranojnë ndryshimin vetëm kur janë përballur me nevojën dhe nevojën e njohin vetëm kur një krizë të bjerë mbi ta”. Por progresi mund dhe duhet të bëhet pa prituri për një krizë. Zbatimi i *Solvency II* i jep të gjithë mbikëqyrësve të sigurimit në Bashkimin Evropian një mundësi të jashtëzakonshme për të ndryshuar dhe për të konvertuar në një proces nga poshtë-lart drejt një kulture mbikëqyrëse evropiane të bazuar në praktikat më të mira dhe efektive mbikëqyrëse. EIOPA është plotësisht e angazhuar për të udhëhequr rrugën përpara.

## Çeki

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Çekisë (*Czech Insurance Association CAP*), në tremujorin e tretë, tregu i sigurimeve ka qenë i ndikuar më së shumti nga Sigurimet e Jo-Jetës të cilat arritën një normë rritjeje prej 4.2%, ndërkohë që sigurimet e Jetës vazhduan të kenë rënie me rreth 2.1%.

Në total, primet e shkruara bruto u rritën fare pak, duke arritur në 89.57 miliardë CZK ose rreth 3.32 miliardë euro, e cila i korrespondon një norme rritjeje vjetore prej 1.8%.

## Gjeorgji

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të publikuara nga Mbikëqyrësi i Sigurimeve në Gjeorgji (*Insurance Supervisory Office – ISO*) gjatë tremujorit të tretë tregu i sigurimeve i Gjeorgjisë arriti një volum të primeve të shkruara bruto prej 316.3 milionë GEL (monedha lokale *Georgian Lari*) ose rreth 121 milionë euro duke shënuar kështu një rritje prej 8.2%.

Tendenca pozitive në tregun e sigurimeve u nxit nga rritja e primeve të shkruara bruto në klasat e sigurimit të shëndetit me + 13%, sigurimit të Jetës me +12% dhe MTPL me + 10%. Rritje më të vogël kishte në disa klasa të tjera sigurimesh.

## Hungari

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Duke ju referuar portalit të revistës [www.portfolio.hu](http://www.portfolio.hu) Ministria Kombëtare e Ekonomisë së Hungarisë paraqiti më 28 tetor një paketë të re taksash në Parlament, duke kërkuar heqjen e pjesës prej 6% mbi interesat nga kontributet e sigurimit shëndetësor për produkte të ndryshme financiare, përfshirë edhe policat e sigurimit të Jetës që kanë rreth 80% të aseteve të tyre në letra me vlerë në Forinta (monedhën lokale).

Në lajmin e publikuar thuhet se të gjithë do të përjashtohen nga kontributi shëndetësor 6% mbi të ardhurat nga interesi për vitin e ardhshëm. Sistemi me pesë kategori: 6%, 14%, 15%, 20%, 27%, për llojet e ndryshme të të ardhurave do të zëvendësohet nga një sistem me dy kategori me normat e 14% dhe 27%.



## Kroaci

<https://seenews.com/news/slovenia-croatia-lead-by-insurance-market-development-in-ex-yu-region-sp-546834#sthash.Ciwge5Ep.dpuf> <https://seenews.com/news/slovenia-croatia-lead-by-insurance-market-development-in-ex-yu-region-sp-546834>

Sipas *S&P Global Ratings*, 25 vjet pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Sllovenia dhe Kroacia janë qartësisht të parët në drejtim të zhvillimit të tregjeve të sigurimeve mes Republikave të ish Federatës Jugosllave.

Në një njoftim për shtyp të publikuar, analisti i kreditimit të *S&P Global Ratings*, z. Jure Kimovec thekson se "...në shumicën e vendeve të tjera të ish Jugosllavisë, depërtimi i sigurimit ka rënë gjatë 25 viteve të fundit dhe tregjet janë fragmentuar dhe fokusuar në produktet e detyrueshme".

Studiuesit e tregut argumentojnë se në shumë aspekte, para viteve '90 vendi ka pasur një sistem më të sofistikuar të sigurimit midis ekonomive të centralizuara në Evropën Qendrore dhe Lindore. Që atëherë, tregjet e sigurimit në vendet e ish-Jugosllavisë kanë mbetur pas. "Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të zhvillimit të dobët ekonomik dhe rreziqeve të larta politike për këto vende, të ardhurave të ulëta personale, - mungesës së kërkesës për mbrojtje nga sigurimet, si edhe e kuadrit të dobët institucional në këto tregje të sigurimeve, duke përfshirë si rregullimin, mbikëqyrjen e qeverisjes së korporatave dhe aftësitë e menaxhimit të rrezikut", theksohet në deklaratën e S&P.

Përrjashtim këtu bëjnë Sllovenia dhe në një farë mase edhe Kroacia, ku gjatë 25 viteve të fundit tregjet e sigurimit kanë qenë në gjendje të kapërcejnë këto probleme dhe t'i afrohen niveleve evropiano-perëndimore me produkte sigurimi të diversifikuara dhe me nivele të ndryshme mbrojtjeje.

## Moldavi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Komisioni Kombëtar i Tregut Financiar në Moldavi (*National Commission of the Financial Market in Moldova CNPF*), në tremujorin e tretë të vitit 2016, volumi total i primeve të shkruara bruto i realizuar nga kompanitë e sigurimit të vendit tejkaloi shifrën e një miliardë MDL (moneda lokale *Moldovan Leu*), afërsisht rreth 45.86 milionë euro. Kjo shifër shënon një rritje prej 11.58% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Rritja u mbështet më shumë nga rritjet e primeve në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, të cilat u rritën me afro 12.31%. Klasat e sigurimeve motorike vazhdojnë të dominojnë tregun e sigurimeve duke arritur në 66.42% të tregut total të sigurimeve. Disa klasa të tjera të sigurimeve të pronave siç janë zjarri dhe rreziqet shtesë, patën rënie në volumin e tyre të primeve të shkruara bruto. Më shumë rënie patën sidomos sigurimi shëndetësor dhe sigurimi nga aksidentet.

**amf** ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)